

LIGJ
Nr. 27/2023

**PËR KONTROLLIN E TREGTIMIT TË PRODUKTEVE QË MUND TË PËRDOREN
PËR DËNIME ME VDEKJE, TORTURË OSE DËNIME APO TRAJTIME MIZORE,
ÇNJERËZORE OSE POSHTËRUESE¹**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Ky ligj përcakton rregullat dhe procedurat për kontrollin e tregtimit të produkteve që mund të përdoren për dënime me vdekje, torturë ose dënime apo trajtime mizore, çnjërëzore ose poshtëruese, si dhe ofrimin e shërbimeve të ndërmjetësimit, ndihmës teknike, trajnimin dhe reklamën në lidhje me produkte të tilla.

Neni 2
Përkufizimet

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Autoritet i zbatimit të ligjit” është çdo autoritet përgjegjës për parandalimin, zbulimin, hetimin, luftimin dhe ndëshkimin e veprave penale, duke përfshirë, por pa u kufizuar në policinë, prokurorinë, çdo autoritet gjyqësor, çdo institucion të ekzekutimit të vendimeve penale dhe, kur është e përshtatshme, institucionet shtetërore dhe autoritetet ushtarake.

2. “Autoriteti përgjegjës” është Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve (AKSHE), si struktura shtetërore përgjegjëse për lëshimin e autorizimeve të përcaktuara në pikat 3, 4 dhe 5 të këtij neni, për eksportin, importin, tranzitin, ofrimin e ndihmës teknike dhe veprimtari ndërmjetësuese.

3. “Autorizim global” është autorizimi i lëshuar nga autoriteti përgjegjës për kontrollin shtetëror të eksporteve për një eksportues ose ndërmjetësues të veçantë në lidhje me një produkt apo një kategori të caktuar të produkteve të kontrolluara, i cili është i vlefshëm për:

a) eksportet te një ose më shumë përdorues të fundit të specifikuar dhe/ose në një ose më shumë vende të huaja të specifikuara;

b) eksportet në një ose më shumë shpërndarës të posaçëm, në një ose më shumë vende të huaja të specifikuara, ku eksportuesi është një prodhues i mallrave;

c) furnizimin e shërbimeve të ndërmjetësimit në lidhje me transferimet e mallrave që ndodhen në një vend të huaj te një ose më shumë përdorues të caktuar në një ose më shumë vende të huaja;

ç) furnizimin e shërbimeve të ndërmjetësimit në lidhje me transferimet e mallrave që ndodhen në një vend të huaj, në një ose më shumë shpërndarës të posaçëm në një ose më shumë vende të huaja, ku ndërmjetësi është një prodhues i mallrave.

4. “Autorizim i përgjithshëm” është autorizimi i lëshuar nga autoriteti përgjegjës për kontrollin shtetëror të eksporteve për një kategori të caktuar mallrash për të kryer një eksport, sipas përkufizimeve

¹ Ky ligj është përafshuar pjesërisht me rregulloren (BE) 2019/125 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 16 janar 2019, “Për tregtinë e mallrave të caktuara, të cilat mund të përdoren për dënim me vdekje, torturë apo trajtime ose dënime të tjera mizore, çnjërëzore ose poshtëruese”, të ndryshuar. Numri CELEX 32019R0125, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 30, datë 31.1.2019, f. 1–57.

të pikës 6 të këtij neni, drejt disa vendeve të huaja të miratuara, i cili jepet për të gjitha subjektet që respektojnë kushtet dhe kërkesat për përdorim, të përcaktuara në autorizimin e përgjithshëm.

5. "Autorizim individual" është një autorizim i dhënë për:

a) një eksportues të posaçëm për të një përdorues fundor ose marrës në një vend të huaj dhe që mbulon një ose më shumë mallra;

b) një ndërmjetës të posaçëm për furnizimin e shërbimeve të ndërmjetësimit për një përdorues fundor ose marrës në një vend të huaj dhe që mbulon një ose më shumë mallra;

c) një person fizik ose juridik, entitet ose organ që transporton mallra brenda territorit doganor të Republikës së Shqipërisë për kalim të përkohshëm tranzit.

6. "Eksport" është një procedurë eksporti në kuptim të Kodit Doganor të Republikës së Shqipërisë, pa përfshirë mallrat në tranzit.

7. "Eksportues" është çdo person fizik ose juridik ose një bashkim i tyre, në emër të të cilit paraqitet deklarata doganore e eksportit, ose personi që, në kohën kur pranohet deklarata, ka kontratën me marrësin e ngarkesës në vendin e huaj dhe ka autoritetin që të vendosë për dërgimin e mallit jashtë territorit doganor të Shqipërisë.

8. "Import" është një procedurë importi në kuptim të Kodit Doganor të Republikës së Shqipërisë.

9. "Importues" është personi fizik apo juridik i vendosur në territorin e Republikës së Shqipërisë, në emër të të cilit bëhet një deklaratë importi, ose një person që në kohën e dhënies së autorizimit ka nënshkruar kontratë me marrësin e mallrave brenda territorit doganor të Republikës së Shqipërisë.

10. "Kërkues" do të thotë:

a) eksportuesi/importuesi në rastin e eksporteve/importeve;

b) personi fizik ose juridik, që transporton mallrat brenda territorit doganor të Republikës së Shqipërisë, në rastin e kalimit tranzit;

c) ofruesi i ndihmës teknike në rastin e ofrimeve të ndihmës teknike;

ç) muzeu që do të ekspozojë mallrat, në rastin e importeve dhe ofrimeve të ndihmës teknike;

d) ndërmjetësi, në rastin e shërbimeve të ndërmjetësimit.

11. "Lista e mallrave të kontrolluara" është një listë e ndarë në tri kategori si më poshtë:

- Kategoria 1: mallra të cilat nuk kanë përdorim tjetër, përveç qëllimit të dënimit me vdekje, ose për qëllime torture ose dënime apo trajtime mizore, çnjerëzore ose poshtëruese;

- Kategoria 2: mallra që mund të përdoren për qëllime torture apo trajtime të tjera apo ndëshkime mizore, çnjerëzore ose poshtëruese;

- Kategoria 3: mallra që mund të përdoren për qëllim të dënimit me vdekje.

12. "Muze" është institucioni i ruajtjes së kujtesës, në shërbim të shoqërisë dhe zhvillimit të saj, i hapur për publikun, që konservon, studion, komunikon dhe prezanton trashëgiminë e luajtshme e të paluajtshme të njerëzimit dhe mjedisit rrethues të tij, me qëllim edukimin, studimin, promovimin dhe argëtimin.

13. "Objekt muzeor" është një pasuri e luajtshme, që, pas hulumtimeve dhe vlerësimit, njihet si një objekt me rëndësi kulturore e historike, që ruhet, mbrohet, administrohet dhe vlerësohet në një muze.

14. "Produkt për arsye muzeore" ka të njëjtin kuptim sipas përcaktimit për objektin muzeor.

15. "Ndërmjetësues" është çdo person fizik, shtetas shqiptar, i cili ofron shërbimin për lidhje të dy ose më shumë palëve për përfundimin e një marrëveshjeje, pa qenë i lidhur me asnjërin prej tyre në marrëdhënie bashkëpunimi, varësie ose përfaqësimi nga brenda Shqipërisë; çdo person fizik ose juridik, apo organ, duke përfshirë dhe një bashkim të tyre, që është rezident ose i vendosur në Shqipëri dhe që ofron këtë lloj ndihme nga brenda Shqipërisë; çdo person fizik ose juridik ose organ i regjistruar ose i krijuar sipas legjislacionit shqiptar, pavarësisht se ku është i vendosur, që ofron shërbime të tilla nga Shqipëria.

16. "Ndihmë teknike" është çdo mbështetje teknike në lidhje me riparimet, zhvillimin, prodhimin, testimin, mirëmbajtjen, montimin ose ndonjë shërbim tjetër teknik dhe mund të marrë forma të tilla, si: udhëzime, këshilla, trajnime, transmetim të njohurive të punës ose aftësive ose këshillime. Ndihma teknike përfshin forma verbale të ndihmës dhe ndihmës së siguar me mjete elektronike.

17. "Ofrues i ndihmës teknike" është çdo shtetas shqiptar, pavarësisht se ku është rezident, i cili ofron këtë lloj ndihme nga brenda Shqipërisë; çdo person fizik ose juridik, ose organ, duke përfshirë një bashkim të tyre, që është rezident ose i vendosur në Shqipëri dhe që ofron këtë lloj ndihme nga brenda Shqipërisë; çdo person fizik ose juridik ose organ i regjistruar ose i krijuar sipas legjislacionit

shqiptar, pavarësisht se ku është i vendosur, që ofron shërbime të tilla nga Shqipëria dhe që ofron ndihmën teknike për mallrat e përcaktuara në pikën 12 të këtij neni.

18. “Organ” në kuptim të këtij ligji do të konsiderohen organet publike sipas përkufizimit të dhënë në Kodin e Procedurave Administrative.

19. “Person fizik” në kuptim të këtij ligji është një person i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe i pajisur me numër unik të identifikimit të subjektit.

20. “Rieksport” është procedurë rieksporti në kuptim të Kodit Doganor të Republikës së Shqipërisë, pa përfshirë mallrat në regjimin e tranzitit.

21. “Shpërndarës” është një person fizik ose juridik, që kryen tregti me shumicë në lidhje me mallrat e kategorive 2 dhe 3, duke i prokuruar këto mallra nga prodhuesi ose duke furnizuar apo eksportuar këto mallra. Tregtia kuptohet si blerja e mallrave nga prodhuesi ose mbajtja, ofrimi apo eksportimi i këtyre mallrave, përveç prokurimit të mallrave nga ana e institucioneve të kujdesit shëndetësor.

22. “Torturë” është çdo veprim me dashje, me anën e të cilit i shkaktohet një personi dhimbje ose vuajtje të rënda fizike a mendore, me qëllimin që nga ky person apo nga një i tretë të përftohen informacione apo një rrëfim, duke ndëshkuar atë person për një veprim që ai person ose një i tretë ka kryer ose dyshohet ta ketë kryer apo kërcënimi ose ushtrimi i presionit ndaj atij personi ose një të treti për çfarëdolloj arsyeje të bazuar në çfarëdolloj diskriminimi, kur kjo dhimbje ose vuajtje shkaktohet nga ose me nxitjen, pëlqimin apo miratimin e heshtur të një punonjësi publik apo të një personi tjetër që ushtron një funksion zyrtar. Në këtë përkufizim nuk përfshihet dhimbja ose vuajtja e shaktuar vetëm nga sanksione ekzistuese të ligjshme ose aksidentale.

23. “Trajtime ose ndëshkime mizore, çnjerëzore apo poshtëruese” është çdo veprim nëpërmjet të cilit i shkaktohet një personi dhimbje apo vuajtje fizike a mendore të një niveli minimal, kur kjo dhimbje a vuajtje shkaktohet nga ose me nxitjen, pëlqimin apo miratimin e heshtur të një punonjësi publik apo të një personi tjetër që ushtron një funksion zyrtar. Në këtë përkufizim nuk përfshihet dhimbja ose vuajtja e shaktuar vetëm nga sanksione ekzistuese të ligjshme ose aksidentale.

24. “Tranzit” është procedura në kuptim të Kodit Doganor të Republikës së Shqipërisë dhe dispozitave zbatuese të Kodit Doganor.

25. “Tregtim” në kuptim të këtij ligji do të jetë eksporti, importi, tranziti i produkteve që mund të përdoren për dënime me vdekje, torturë ose dënime apo trajtime mizore, çnjerëzore ose poshtëruese.

26. “Veprimtari ndërmjetësimi” është:

a) negocimi apo organizimi i transaksioneve për blerjen, shitjen ose ofrimin e mallrave të kontrolluara nga një vend i huaj, në cilindo vend tjetër të huaj;

b) blerja, shitja apo organizimi i transferimeve të mallrave të kontrolluara që ndodhen në një vend të huaj drejt një vendi tjetër të huaj.

Në kuptim të këtij ligji, shërbimet ndihmëse, ku përfshihen transporti, shërbimet financiare, sigurimi, risigurimi dhe reklamimi i përgjithshëm ose promovimi nuk konsiderohen veprimtari ndërmjetësimi.

27. “Territori doganor” është territori tokësor, ujërat territoriale, ujërat e brendshme dhe hapësira ajrore e Republikës së Shqipërisë.

KREU II

KONTROLLI MBI MALLRAT TË CILAT NUK KANË PËRDORIM TJETËR PËRVEÇSE PËR QËLLIME TË DËNIMIT ME VDEKJE, TORTURËS DHE DËNIMEVE APO TRAJTIMIT MIZORE, ÇNJERËZORE OSE POSHTËRUESE

Neni 3

Ndalimi i eksportit

1. Ndalohet eksporti i produkteve, të cilat nuk kanë përdorim tjetër përveç qëllimit të dënimit me vdekje, torturës dhe dënimeve apo trajtimeve mizore, çnjerëzore ose poshtëruese.

2. Ndalohet ofrimi i ndihmës teknike në lidhje me produktet, të cilat nuk kanë përdorim tjetër përveçse mund të përdoren për dënime me vdekje, torturë ose dënime apo trajtime mizore, çnjerëzore ose poshtëruese, qoftë edhe pa pagesë, ndaj çdo personi, subjekti apo organi të një vendi të huaj.

3. Përjashtim bëjnë rastet kur përdorimi i këtyre produkteve do të jetë për arsye muzeore.

4. Për rastet e përmendura në pikën 3 të këtij neni, subjektet do të autorizohen për të eksportuar këto produkte dhe ofrimin e ndihmës teknike përkatëse nga ana e autoritetit përgjegjës për kontrollin shtetëror të eksporteve, nëse kërkuesi paraqet deklaratë me shkrim që sendi është jofunksional dhe konfirmimin që këto mallra do të përdoren ekskluzivisht për t'u shfaqur nga muzeu në të cilin do të ekspozohet.

5. Lista e produkteve, të cilat nuk kanë përdorim tjetër përveç qëllimit të dënimit me vdekje, torturës ose dënime apo trajtime mizore, çnjerëzore ose poshtëruese, përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave. Kjo listë përditësohet çdo herë në përputhje me listat më të fundit që miraton Bashkimi Evropian

Neni 4

Ndalimi i importit

1. Ndalohet importi i produkteve, të cilat nuk kanë përdorim tjetër përveç qëllimit të dënimit me vdekje, torturës ose dënime apo trajtime mizore, çnjerëzore ose poshtëruese.

2. Ndalohet çdo person fizik ose juridik apo organ në Republikën e Shqipërisë të pranojë ndihmë teknike, qoftë edhe pa pagesë, që ofrohet nga një person, subjekt apo organ në një vend të huaj për mallrat e rregulluara nga ky kre.

3. Përjashtim bëjnë rastet kur përdorimi i këtyre produkteve do të jetë për arsye muzeore.

4. Për rastet e përmendura në pikën 3 të këtij neni, subjektet do të autorizohen për të importuar këto produkte dhe ofrimin e ndihmës teknike përkatëse nga ana e autoritetit përgjegjës për kontrollin shtetëror të eksporteve, nëse kërkuesi paraqet deklaratë me shkrim që sendi është jofunksional dhe konfirmimin që këto mallra do të përdoren ekskluzivisht për t'u shfaqur nga muzeu në të cilin do të ekspozohet.

Neni 5

Ndalimi i tranzitit

1. Ndalohet kalimi tranzit i produkteve, të cilat nuk kanë përdorim tjetër përveç qëllimit të dënimit me vdekje, torturës ose dënime apo trajtime mizore, çnjerëzore ose poshtëruese, përmes territorit doganor të Republikës së Shqipërisë në territorin e një vendi të huaj.

2. Përjashtim bëjnë rastet kur përdorimi i këtyre produkteve do të jetë për arsye muzeore.

3. Për rastet e përmendura në pikën 2 të këtij neni, subjektet do të autorizohen për të tranzituar nga ana e autoritetit përgjegjës për kontrollin shtetëror të eksporteve, nëse kërkuesi provon se mallrat në vendin e destinacionit do të përdoren ekskluzivisht për t'u shfaqur në muze.

Neni 6

Ndalimi i ofrimit të shërbimeve të ndërmjetësimit

Ndalohet sigurimi i shërbimeve të ndërmjetësimit ndaj çdo personi, subjekti, ose organi të një vendi të huaj për mallrat, të cilat nuk kanë përdorim tjetër përveç dënimit me vdekje, torturës ose dënime apo trajtime mizore, çnjerëzore ose poshtëruese, pavarësisht nga origjina e këtyre mallrave.

Neni 7

Ndalimi i ofrimit të ndihmës teknike

Ndalohet ofrimi i ndihmës teknike ose ofrimi i trajnimit ndaj çdo personi, subjekti ose organi të një vendi të huaj për përdorimin e mallrave, të cilat nuk kanë qëllim tjetër, përveç përdorimit për dënime me vdekje, torturës ose dënime apo trajtime mizore, çnjerëzore ose poshtëruese.

Neni 8

Ndalimi i reklamimit dhe shfaqjes së mallrave në panaire

1. Ndalohet shitja ose blerja e hapësirës së reklamimit apo kohës së reklamimit në Republikën e Shqipërisë për çdo individ, person fizik ose juridik, apo organ, duke përfshirë një bashkim ndërmjet tyre, që është rezident apo i themeluar në Republikën e Shqipërisë, për çdo shtetas shqiptar që shet ose blen hapësirë reklamimi ose kohë reklamimi brenda Republikës së Shqipërisë, dhe për çdo person fizik ose juridik apo organ të themeluar apo të krijuar sipas legjislacionit shqiptar, që shet ose blen hapësirë reklamimi ose kohë reklamimi brenda Republikës së Shqipërisë, për t'i shitur ose blerë, çdo personi, subjekti ose organi të një vendi të huaj, hapësirë reklamimi në medien e shkruar ose në internet ose kohë reklamimi në televizion ose radio për mallrat, të cilat nuk kanë përdorim tjetër përveçse të përdorimit për dënime me vdekje, torturë ose dënime apo trajtime mizore, çnjerëzore ose poshtëruese.

2. Ndalohen të ekspozohen apo të ofrohen për shitje, në një ekspozitë apo panair që zhvillohet në Shqipëri, mallra të cilat nuk kanë përdorim tjetër përveçse përdorimit për dënime me vdekje, torturë ose dënime apo trajtime mizore, çnjerëzore ose poshtëruese, nga çdo individ, person fizik ose juridik, apo organ, duke përfshirë një bashkim ndërmjet tyre, që është rezident ose i themeluar apo jo në Shqipëri, përveçse nëse kërkuesi vërteton pranë autoritetit përgjegjës për kontrollin shtetëror të eksporteve se, duke pasur parasysh natyrën e ekspozitës ose panairit, kjo ekspozitë apo oferta për shitje nuk është e rëndësishme dhe nuk promovon shitjen apo furnizimin e këtyre mallrave tek asnjë person, subjekt apo organ në një vend të huaj.

KREU III

KONTROLLI I MALLRAVE QË MUND TË PËRDOREN PËR QËLLIME TORTURE APO NDËSHKIME MIZORE, ÇNJERËZORE OSE POSHTËRUESE

Neni 9

Autorizimi individual ose global i eksportit

1. Për çdo eksport të mallrave, që mund të përdoren për qëllime torture apo ndëshkime mizore, çnjerëzore apo poshtëruese, është i nevojshëm një autorizim, ku përfshihen:

a) mallrat që përdoren për qëllimet e autoriteteve të zbatimit të ligjit;

b) mallrat që, duke pasur parasysh dizajnin dhe tiparet teknike, paraqesin një rrezik material për t'u përdorur për torturë dhe trajtime ose dënime mizore, çnjerëzore apo poshtëruese.

2. Nuk kërkohet autorizim në rastet e kalimit tranzit përmes territorit doganor të Republikës së Shqipërisë të mallrave që mund të përdoren për qëllime torture apo ndëshkime mizore, çnjerëzore apo poshtëruese.

3. Përjashtohen nga rregullimet e këtij neni mallrat e mëposhtme:

a) armët e zjarrit të kontrolluara sipas legjislacionit në fuqi;

b) artikujt me përdorim të dyfishtë të kontrolluar sipas legjislacionit në fuqi;

c) mallrat ushtarake të kontrolluara sipas legjislacionit në fuqi.

4. Pika 1 e këtij neni nuk zbatohet për eksportet në vendet e huaja, me kusht që mallrat të përdoren nga personeli ushtarak ose civil i Republikës së Shqipërisë, nëse një personel i tillë merr pjesë në një mision ushtarak, operacion paqeruajtës ose menaxhim emergjencash. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe autoritetet e tjera përkatëse kanë të drejtë të verifikojnë nëse ky kusht është përmbushur. Eksporti nuk do të bëhet deri në pritje të një verifikimi të tillë.

5. Lista e mallrave, që mund të përdoren për qëllime torture ose ndëshkime mizore, çnjerëzore apo poshtëruese, përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave. Kjo listë përditësohet çdo herë në përputhje me listat më të fundit që miraton Bashkimi Evropian.

Neni 10

Kushtet për dhënien e autorizimeve individuale dhe globale për eksport

1. Vendimi për kërkesat për autorizimet lidhur me eksportin e mallrave sipas nenit 9 të këtij ligji, merret nga Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve pas marrjes së mendimit të organeve të tjera shtetërore, sipas fushës së kompetencës, të cilat marrin në konsideratë të gjitha rrethanat dhe, në veçanti, përdorimin përfundimtar të synuar dhe nëse ka rrezik devijimi nga ky përdorim.

2. Autoriteti kompetent nuk jep asnjë autorizim kur ka baza të arsyeshme për të besuar se mallrat e përcaktuara në nenin 9 të këtij ligji, mund të përdoren nga një autoritet ligjzbatues apo nga një person fizik ose juridik në një vend të huaj për torturë dhe trajtime ose dënime të tjera mizore, çnjerëzore apo poshtëruese, përfshirë këtu ndëshkimin trupor me vendim gjyqësor.

3. Për vlerësimin e eksportit, autoriteti kompetent merr në konsideratë:

a) vendimet gjyqësore të dhëna nga gjykata ndërkombëtare;

b) rezultatet e vlerësimeve të organeve kompetente të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, Këshillit të Evropës dhe Bashkimit Evropian, raportet e Komitetit Evropian, të Këshillit të Evropës për Ndalimin e Torturës dhe Trajtimeve ose Dënimeve Mizore, Çnjerëzore apo Poshtëruese dhe të Raportuesit Special të Organizatës së Kombeve të Bashkuara për torturën dhe trajtimet ose dënimet e tjera mizore, çnjerëzore apo poshtëruese.

c) informacione të tjera të rëndësishme, si vendimet gjyqësore ndërkombëtare të disponueshme ose publike, raportimet dhe informacionet e tjera të përgatitura nga organizatat e shoqërisë civile dhe informacioni mbi kufizimet për eksportin e mallrave sipas krerëve I dhe II, që aplikohen drejt vendit të destinacionit.

4. Kur prodhuesi i mallrave të parashikuara nga neni 9 i këtij ligji, kërkon një autorizim për eksportin e këtyre mallrave drejt një shpërndarësi, autoriteti kompetent bën një vlerësim të marrëveshjeve kontraktuale midis prodhuesit dhe shpërndarësit, si dhe të masave të marra prej tyre për të garantuar që këto mallra ose, sipas rastit, produktet ku ato do të inkorporohen, nuk përdoren për torturë dhe trajtime ose dënime mizore, çnjerëzore apo poshtëruese.

5. Kur për eksportin e mallrave të parashikuara nga neni 9 i këtij ligji, drejt një përdoruesi fundor kërkohet një autorizim, autoriteti kompetent kërkon deklaratën e përdorimit fundor të nënshkruar nga përdoruesi fundor.

6. Përveç kushteve të përcaktuara në këtë nen, gjatë vlerësimit të një kërkesë për autorizim global, autoriteti përgjegjës merr në konsideratë zbatimin nga eksportuesi të mjeteve dhe procedurave që garantojnë pajtueshmërinë me dispozitat dhe objektivat e këtij ligji dhe me kushtet e autorizimit.

Neni 11

Ndalimi i tranzitit

Ndalohet që një individ, person fizik ose juridik apo organ, përfshirë këtu një bashkim të tyre, qoftë rezident ose i themeluar në Shqipëri apo jo, të kalojë tranzit mallrat e parashikuara nga neni 9 i këtij ligji, që mund të përdoren për qëllime torture, trajtime ose ndëshkime mizore, çnjerëzore apo poshtëruese, nëse ky individ, person fizik ose juridik apo organ ka dijeni se një pjesë e dërgesës së këtyre mallrave ose e gjitha është e synuar për përdorimin për torturë dhe trajtime ose dënime mizore, çnjerëzore apo poshtëruese në një vend të huaj.

Neni 12

Autorizim individual ose global për disa shërbime

1. Kërkohet autorizim për çdo shërbim nga një ofrues i ndihmës teknike apo ndërmjetës, pavarësisht origjinës së këtyre mallrave, në favor të një personi, subjekti apo organi në një vend të huaj, pavarësisht nëse ofrohen ose jo me pagesë, për secilin nga shërbimet e mëposhtme:

a) ndihmë teknike lidhur me të gjitha mallrat e parashikuara nga ky kre, pavarësisht nga origjina e tyre;

b) shërbime ndërmjetësimi lidhur me të gjitha mallrat e parashikuara nga ky kre, pavarësisht nga origjina e tyre.

2. Në marrjen e vendimit për kërkesat për autorizim për ofrimin e ndihmës teknike zbatohen kushtet e përcaktuara në pikat 3, 4, 5 dhe 6 të nenit 10 të këtij ligji, për të vlerësuar nëse:

a) ndihma teknike i jepet një personi ose subjekti që mund t'i përdorë mallrat për të cilat jepet ndihma teknike për torturë dhe trajtime ose dënime mizore, çnjerëzore apo poshtëruese;

b) ndihma teknike do të përdoret për riparimin, zhvillimin, prodhimin, testimin, mirëmbajtjen apo montimin e mallrave të destinuar për një person, subjekt apo organ me qëllim që këtyre të fundit t'u

jepet ndihma teknike për mallrat që mund të përdoren për torturë dhe trajtime ose dënime mizore, çnjerëzore apo poshtëruese.

3. Pika 1 e këtij neni nuk zbatohet për ofrimin e ndihmës teknike, nëse ndihma teknike:

a) i jepet në kuadër të parashikimeve të pikës 4 të nenit 9 të këtij ligji;

b) konsiston në dhënien e informacionit që është publik;

c) është minimumi i nevojshëm për instalimin, funksionimin, mirëmbajtjen apo riparimin e mallrave, eksporti i të cilave është autorizuar nga një autoritet kompetent në përputhje me këtë ligj.

4. Një autorizim për eksport për ndihmë teknike nënkupton një autorizim për eksportuesin për të furnizuar me ndihmë teknike përdoruesin përfundimtar në masën që ndihma e tillë është e nevojshme për instalimin, funksionimin, mirëmbajtjen ose riparimin e atyre mallrave, eksporti i të cilave është i autorizuar.

KREU IV MALLRAT QË MUND TË PËRDOREN PËR DËNIMIN ME VDEKJE

Neni 13

Autorizimi individual ose global për eksport dhe tranzitim

1. Kërkohet një autorizim për çdo eksport të mallrave që mund të përdoren për dënimin me vdekje, ku përfshihen ato mallra që janë miratuar apo përdoren aktualisht për dënimin me vdekje nga një ose më shumë vende, të cilat nuk e kanë shfuqizuar këtë lloj dënimi.

2. Nuk kërkohet autorizim në rastet e kalimit tranzit përmes territorit doganor të Republikës së Shqipërisë të mallrave që mund të përdoren për dënimin me vdekje.

3. Përjashtohen nga rregullimet e këtij neni mallrat e mëposhtme:

a) armët e zjarrit, të kontrolluara sipas legjislacionit në fuqi;

b) artikujt me përdorim të dyfishtë, të kontrolluara sipas legjislacionit në fuqi;

c) mallrat ushtarake, të kontrolluara sipas legjislacionit në fuqi.

4. Kur në zbatim të këtij ligji, eksporti i produkteve mjekësore kërkon një autorizim, ky eksport u nënshtrohet gjithashtu edhe kërkesave për licencim/autorizim në përputhje me legjislacionin vendas për kontrollin e lëndëve narkotike dhe substancave psikotrope.

5. Përveç kushteve të përcaktuara në këtë nen, gjatë vlerësimit të një kërkesë për autorizim global, autoriteti kompetent merr në konsideratë zbatimin nga eksportuesi/tranzituesi të mjeteve dhe procedurave që garantojnë pajtueshmërinë me dispozitat dhe objektivat e këtij ligji dhe me kushtet e autorizimit.

6. Lista e mallrave, që mund të përdoren për dënimin me vdekje, përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave. Kjo listë përditësohet çdo herë në përputhje me listat më të fundit që miraton Bashkimi Evropian.

Neni 14

Kushtet për dhënien e autorizimeve individuale ose globale për eksport

1. Vendimi mbi kërkesat për autorizime lidhur me eksportin e mallrave, të përcaktuara në nenin 13 të këtij ligji, merret nga Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve pas marrjes së mendimit të organeve të tjera shtetërore, sipas fushës së kompetencës, të cilat marrin në konsideratë të gjitha rrethanat përkatëse, në veçanti përdorimin përfundimtar të synuar dhe nëse ka rrezik devijimi nga ky përdorim.

2. Autoriteti kompetent nuk jep asnjë autorizim kur ka baza të arsyeshme për të besuar se mallrat mund të përdoren për dënimin me vdekje në një vend të huaj.

3. Kur prodhuesi i mallrave, të parashikuara në nenin 13 të këtij ligji, kërkon një autorizim për eksportin e këtyre mallrave drejt një shpërndarësi, autoriteti kompetent bën një vlerësim të marrëveshjeve kontraktuese midis prodhuesit dhe shpërndarësit, si dhe të masave të marra prej tyre për të garantuar që këto mallra ose, sipas rastit, produktet ku ato do të inkorporohen, nuk do të përdoren për dënimin me vdekje.

4. Kur për eksportin e mallrave të parashikuara nga neni 13 i këtij ligji, drejt një përdoruesi fundor kërkohet një autorizim eksporti, autoriteti kompetent i vendit eksportues kërkon deklaratën e përdorimit fundor të nënshkruar nga përdoruesi fundor.

5. Përveç kushteve të përcaktuara në këtë nen, gjatë vlerësimit të një kërkesë për autorizim global, autoriteti kompetent merr në konsideratë zbatimin nga eksportuesi të mjeteve dhe procedurave që garantojnë pajtueshmërinë me dispozitat dhe objektivat e këtij ligji dhe me kushtet e autorizimit.

Neni 15

Ndalimi i tranzitit

Ndalohet që një individ, person fizik ose juridik, apo organ, përfshirë këtu një bashkim të tyre, qoftë rezident ose i themeluar në Shqipëri apo jo, të kalojë tranzit mallrat e parashikuara në nenin 13, nëse ky individ, person fizik ose juridik, apo organ ka dijeni se këto mallra ose një pjesë e dërgesës së këtyre mallrave synohet të përdoret për dënim me vdekje në një vend të huaj.

Neni 16

Autorizimi individual ose global për ofrimin e disa shërbimeve

1. Kërkohet autorizim për çdo shërbim nga një ofruer i ndihmës teknike apo ndërmjetës për secilin nga shërbimet e mëposhtme në favor të një personi, subjekti apo organi në një vend të huaj, pavarësisht nëse ofrohen ose jo me pagesë dhe pavarësisht origjinës:

- a) ndihmë teknike lidhur me të gjitha mallrat e rregulluara nga ky kre;
- b) shërbime ndërmjetësimi lidhur me të gjitha mallrat e rregulluara nga ky kre.

2. Në marrjen e vendimit për kërkesat për autorizim për ofrimin e shërbimeve të ndërmjetësimi zbatohen kushtet e përcaktuara në nenin 14 të këtij ligji për mallrat e rregulluara nga ky kre.

Në marrjen e vendimit për kërkesat për autorizim për ofrimin e ndihmës teknike zbatohen kushtet e përcaktuara në nenin 14 të këtij ligji për e rregulluara nga ky kre për të vlerësuar nëse:

a) ndihma teknike i jepet një personi, subjekti apo organi që mund t'i përdorë mallrat për dënimin me vdekje me të cilat lidhet ndihma teknike, dhe

b) ndihma teknike do të përdoret për riparimin, zhvillimin, prodhimin, testimin, mirëmbajtjen apo montimin e mallrave të rregulluara nga ky kre, apo për të ofruar ndihmë teknike për një person, subjekt ose organ, që mund të përdorë mallrat për dënimin me vdekje me të cilat lidhet ndihma teknike ”.

3. Pika 1 e këtij neni nuk zbatohet për ofrimin e ndihmës teknike nëse:

- a) ndihma teknike konsiston në dhënien e informacionit që është publik;
- b) ndihma teknike është minimumi i nevojshëm për instalimin, funksionimin, mirëmbajtjen apo riparimin e mallrave, eksporti i të cilave është autorizuar nga një autoritet kompetent, në përputhje me këtë ligj.

KREU V

LLOJET E AUTORIZIMEVE DHE PROCEDURAT E LËSHIMIT

Neni 17

Llojet e autorizimeve dhe autoritetet përgjegjëse

1. Autoriteti përgjegjës lëshon autorizimet individuale, të përgjithshme apo globale. Për produktet e përmendura në kreun II të këtij ligji, për qëllime muzeore lëshon vetëm autorizime individuale për import, eksport, tranzit dhe për ndihmën teknike. Ndërsa për produktet e parashikuara në krerët III dhe IV të këtij ligji lëshon autorizime individuale ose globale për eksport, ofrimin e shërbimeve të ndërmjetësimi dhe ndihmës teknike.

2. Autorizimi individual është i vlefshëm për një periudhë të përcaktuar kohe, por jo më shumë se 1 vit. Autoriteti përgjegjës për kontrollin shtetëror të eksporteve, bazuar në kërkesën e kërkuarit, mund ta zgjasë këtë periudhë, por jo përtej afatit të vlefshmërisë së parashikuar në marrëveshjen/kontratën së cilës i referohet ky autorizim dhe jo përtej afatit të autorizimit.

3. Autorizimi i përgjithshëm është i vlefshëm për një afat trevjeçar dhe mund të përdoret nga të gjithë personat fizikë/juridikë, të cilët veprojnë në përputhje me kërkesat dhe kushtet e parashikuara nga ky ligj, aktet nënligjore, si dhe në përputhje me kushtet e përcaktuara në autorizimin e përgjithshëm për dërgimin e mallrave në shtetet e listuara në këtë autorizim.

4. Autorizimi i përgjithshëm i eksportit mund të mbulojë, gjithashtu, ofrimin e ndihmës teknike për përfituesin përfundimtar, kur kërkohet një ndihmë e tillë për instalimin e mallrave, trajtimin e mallrave, mirëmbajtjen ose riparimin e mallrave, eksporti i të cilave është i miratuar, nëse eksportuesi ofron një ndihmë të tillë.

5. Autorizimi global është i vlefshëm për një periudhë të caktuar kohe, por jo më shumë se 2 vjet. Autoriteti përgjegjës për kontrollin shtetëror të eksporteve, bazuar në kërkesën e kërkuarit, mund ta zgjasë këtë periudhë, por jo përtej afatit të vlefshmërisë së parashikuar në marrëveshjen/kontratën së cilës i referohet ky autorizim dhe jo përtej afatit të autorizimit.

6. Autorizimet e mallrave dhe shërbimeve të përcaktuara pikat 1, 2, 3, 4 e 5 të këtij neni, lëshohen nga autoriteti përgjegjës për kontrollin shtetëror të eksporteve me kërkesë të një personi fizik/juridik privat ose publik, në formë shkresore ose me mjete elektronike, nëpërmjet sistemeve të ngritura për këtë qëllim.

7. Këshilli i Ministrave miraton me vendim modelet standarde të autorizimeve, tarifave e autorizimeve, formatet e kërkesave për këto dokumente, afatet dhe procedurat për lëshimin për të tria llojet e autorizimeve të përcaktuara në këtë nen.

8. Një autorizim i përgjithshëm për eksportin miratohet me vendim të Autoritetit të Kontrollit Shtetëror të Eksporteve, duke përcaktuar kushtet për përdorimin e këtij autorizimi, mallrat dhe shtetet e huaja ku do të eksportohet.

Neni 18

Paraqitja e kërkesës për lëshimin e autorizimit individual, global dhe të përgjithshëm

1. Për pajisjen me autorizim kërkuar duhet të përcaktojë personin në emër të të cilit eksportohen ose importohen mallrat, ose ofruesin e shërbimeve, i cili duhet të ketë një kontratë me marrësin në një vend të huaj dhe autoritetin për të vendosur për dërgimin e mallrave jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë. Përfundimtarisht bën rasti kur në kontratën e eksportit është përcaktuar një palë kontraktuese, e cila vepron në emrin e dikujt tjetër. Në këtë rast kërkesa mund të paraqitet nga një person i autorizuar, i cili ka të drejtë të vendosë për dërgesën e mallrave jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë.

2. Pas depozitimit të kërkesës, autoriteti përgjegjës për kontrollin shtetëror të eksporteve merr në shqyrtim dokumentacionin e depozituar nga pala kërkuar dhe vendos, sipas rastit, pranimin ose jo të kërkesës, brenda 20 ditëve.

3. Në rast se dokumentacioni i depozituar nga pala kërkuar nuk është i plotë ose nevojiten shpjegime, autoriteti përgjegjës për kontrollin shtetëror të eksporteve i komunikon palës kërkuar dokumentacionin ose informacionin e kërkuar dhe i lë një afat të ri për plotësimin e kërkesave, jo më pak se 5 ditë. Ky afat e pezullon afatin e parashikuar në pikën 3 të këtij neni.

4. Kundër vendimit të autoritetit përgjegjës për kontrollin shtetëror të eksporteve mund të ushtrohet ankimi në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative.

Neni 19

Dokumentacioni për aplikim për autorizime individuale, globale dhe të përgjithshme për importin, eksportin dhe ofrimin e shërbimeve

Për pajisjen me autorizim, kërkuar duhet të paraqesë dokumentacionin si më poshtë:

- a) emrin, selinë e personit fizik ose juridik, përkatësisht emri dhe adresa e aktivitetit, letërnjoftimi ose numri i pasaportës i përfaqësuesit ligjor dhe vendbanimi;
- b) emrin, përshkrimin, kodin tarifor, numrin dhe sasinë e mallrave ose shërbimeve;
- c) qëllimin e përdorimit të mallrave ose shërbimeve;
- ç) vlerën totale të mallrave ose shërbimeve;

- d) të dhëna për pjesëmarrësit e tjerë të transaksionit: prodhuesi, eksportuesi, importuesi, blerësi, transportuesi i mallrave, ndërmjetësit, nëse dihen;
- dh) emrin dhe adresën e përdoruesit përfundimtar;
- e) mënyrën e pagesës për mallrat ose shërbimet;
- ë) muzeun që do të ekspozojë mallrat, në rastin e importit ose eksportit dhe ndihmës teknike për produktet e parashikuara në kreun II të këtij ligji;
- f) deklaratën e përdoruesit fundor të këtyre mallrave për qëllimin e përdorimit të tyre.

Neni 20

Dokumentacioni i kërkuar për dhënien e autorizimeve individuale ose globale për tranzit

Për pajisjen me autorizim për tranzitimin, kërkuesi duhet të përcaktojë dhe/ose të paraqesë:

- a) personin në emër të të cilit eksportohen dhe importohen mallrat;
- b) kontratën ose marrëveshjen me marrësin ose dërguesin në një vend të huaj, i cili ka autoritetin për të dërguar mallrat;
- c) rezidencën, vendbanimin ose selinë e aktivitetit në Republikën e Shqipërisë;
- ç) të dhëna për pjesëmarrësit e tjerë të transaksionit: prodhuesi, eksportuesi, importuesi, blerësi, transportuesi i mallrave, ndërmjetësit, nëse dihen;
- d) deklaratën e përdoruesit të fundit dhe autorizimin e eksportit nga vendi eksportues nëse ka.

Neni 21

Detyrimet e prodhueseve për autorizimet e eksportit

Kur një prodhues ose përfaqësues i një prodhuesi duhet të eksportojë ose të shesë dhe të transferojë mallra, sipas përcaktimit të kreut III ose kreut IV të këtij ligji, te një shpërndarës në një vend të huaj, ai duhet të sigurojë informacion për rregullimet e bëra dhe masat e marra për të parandaluar që mallrat e përfshira në kreun III të përdoren për tortura ose trajtime apo ndëshkime të tjera mizore, çnjerëzore ose poshtëruese ose për të parandaluar mallrat e përfshira në kreun IV nga përdorimi për dënim me vdekje, në vendin e destinacionit, si dhe informacion për përdorimin përfundimtar dhe përdoruesin fundor të mallrave.

Neni 22

Refuzimi i autorizimit

1. Autoriteti përgjegjës refuzon kërkesën për autorizim me vendim të arsyetuar nëse:
 - a) kërkuesi deklaron informacion të pasaktë në kërkesën për autorizim;
 - b) të dhënat e depozituara në kërkesë janë të falsifikuara;
 - c) në rastet e tjera të përcaktuara me këtë ligj.
2. Në rast të refuzimit të kërkesës për autorizim, Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve do të informojë kërkuenin për arsytet e moslëshimit të autorizimit, pa përmendur të dhënat e konsideruara sekrete, në përputhje me legjislacionin që rregullon informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror”.
3. Vendimi i refuzimit të autorizimit mund të ankimohet në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative.

Neni 23

Shfuqizimi i autorizimit

1. Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve shfuqizon autorizimin e lëshuar nëse vlerëson se:
 - a) ka pasur një ose disa devijime ose shkelje nga kushtet e përcaktuara për dhënien e autorizimit pa miratimin e autoritetit licencues;
 - b) i autorizuari nuk i përmbush kushtet e përcaktuara në autorizim;
 - c) autorizimi është dhënë në bazë të informacionit të pasaktë apo të paplotë.
 - ç) janë plotësuar kushtet për zbatimin e pikës 3 të nenit 29 të këtij ligji.

2. Vendimi i shfuqizimit të autorizimit mund të ankimohet në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative.

KREU VI DETYRIMET E SUBJEKTEVE TË PAJISURA ME AUTORIZIM DHE BASHKËPUNIMI NDËRINSTITUCIONAL

Neni 24

Bashkëpunimi ndërinstytucional

1. Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve, kur vendos për kërkesën për autorizim për eksport, ndihmë teknike apo shërbime ndërmjetësimi, merr mendim nga institucionet e tjera të administratës shtetërore, sipas fushës së përgjegjësisë. Në rastet e mallrave, të cilat do të përdoren për muze, duhet të marrë mendim nga ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore.

2. Pas marrjes së kërkesës për lëshimin e një autorizimi, Autoriteti për Kontrollin Shtetëror të Eksporteve u përcjell kërkesën organeve të administratës shtetërore, përgjegjëse për punët e jashtme dhe të brendshme, si dhe organeve të tjera përgjegjëse për fushën e mallrave ose shërbimeve.

3. Organet e përmendura në pikën 2 të këtij neni, kur japin mendim, duhet të marrin parasysh:

a) vendimet e gjykatës ndërkombëtare;

b) vendimet dhe të dhënat e organeve kompetente të Kombeve të Bashkuara dhe organizatave të tjera ndërkombëtare që janë të detyrueshme për Republikën e Shqipërisë.

4. Institucionet e përmendura në pikat 1 dhe 2 të këtij neni, si dhe institucionet e tjera që mund të angazhohen në kontrollin e mallrave të kontrolluara, kthejnë përgjigje brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve. Në rast se informacioni nuk mund t'u vihet në dispozicion brenda këtij afati në mënyrë të justifikuar, palët bien dakord për shtyrjen e tij.

5. Autoriteti Shtetëror i Kontrollit të Eksporteve mund të vërë informacion në dispozicion të mekanizmit parandalues kombëtar të ngritur në bazë të protokollit opsional të Konventës kundër Torturës dhe Trajtimit ose Dënimit Mizor, Çnjerëzor apo Poshtëruar.

Neni 25

Detyrimet e mbajtjes së të dhënave për subjektet e autorizuara për mallra të kontrolluara

Subjektet janë të detyruara të arkivojnë për një kohë prej të paktën 10 vjetësh, pas finalizimit të transferimit ndërkombëtar, dokumentacionin e mëposhtëm për:

a) përshkrimin teknik të mallrave, nomenklaturën e tarifave doganore;

b) sasinë e mallrave në njësi matëse dhe peshë neto të mallrave;

c) emrin dhe adresën e plotë të eksportuesit, importuesit, personit përgjegjës të tranzitit, tranzshipit, rieksportuesit apo ofruesit të shërbimeve të ndërmjetësimit ose të shërbimeve të ndihmës teknike;

ç) emrin dhe adresën e plotë të shitësit apo të marrësit të mallrave;

d) emrin dhe adresën e plotë të përdoruesit të fundit të mallrave;

dh) përshkrimin e shërbimeve të ndërmjetësimit, emrin dhe adresën e plotë të marrësit/marrësve dhe të palëve të tjera (sipas rastit);

e) porositë, faturat, kontratat, fletëporositë, fletët e shoqërimit, listat e ngarkimit dhe dokumente të tjera lidhur me eksportin, importin, tranzitin dhe ofrimin e shërbimeve të ndërmjetësimit ose të ndihmës teknike.

Neni 26

Detyrimet për raportim për subjektet e autorizuara të mallrave të kontrolluara

1. Subjektet, që kanë marrë autorizim, janë të detyruara që:

a) me kërkesë të titullarit të autoritetit përgjegjës për kontrollin e eksporteve apo të një organi tjetër mbikëqyrës, të ofrojnë të gjithë dokumentacionin e përcaktuar në nenin 25 të këtij ligji;

b) të respektojnë kushtet në bazë të të cilave është lëshuar autorizimi dhe të njoftojnë autoritetin përgjegjës për kontrollin e eksporteve brenda 5 ditëve për çdo ndryshim që ka ndodhur në kushtet e autorizimit të lëshuar;

c) të njoftojnë me shkrim për çdo ndryshim lidhur me përdoruesin e fundit apo një palë tjetër brenda 10 ditëve nga data e ndryshimit. Ndryshimet duhet të miratohen nga Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve sipas afateve dhe procedurave të përcaktuara në nenin 18 të këtij ligji për lëshimin e autorizimeve. Në rast se nuk miratohen, autorizimi shfuqizohet;

ç) me kërkesë të Autoritetit të Kontrollit Shtetëror të Eksporteve të sigurojnë konfirmimin e dorëzimit dhe marrjes së mallrave;

d) të kthejnë çdo autorizim të përdorur tek Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve brenda 15 ditëve nga finalizimi i transaksionit përkatës. Në këtë rast autorizimi nuk është më i vlefshëm.

2. Në rast se ndryshimet e raportuara nga subjekti sipas shkronjave “b” dhe “c” të pikës 1, të këtij neni, nuk miratohen nga Autoriteti i Kontrollit Shtetëror i Eksporteve, autorizimi do të konsiderohet i shfuqizuar.

3. Subjektet, të cilat janë pajisur me autorizim, i paraqesin një herë në vit autoritetit përgjegjës të kontrollit shtetëror të eksporteve raport me shkrim për transferimet aktuale të mallrave të përmendura në këto dokumente dhe për përdorimin e këtyre mallrave sipas qëllimit të deklaruar.

KREU VII

KONTROLI DOGANOR, PARANDALIMI I SHKELJEVE DHE SANKSIONET

Neni 27

Kontrolli doganor

1. Kontrolli doganor i mallrave dhe procedurat e tjera doganore kryhen në bazë të Kodit Doganor të Republikës së Shqipërisë dhe të akteve nënligjore të dala në zbatim të tij, si dhe të këtij ligji.

2. Autoriteti përgjegjës për kontrollin shtetëror të eksporteve duhet t’u japë autoriteteve doganore një kopje të autorizimit të lëshuar, si dhe duhet ta informojë për vendimet për pezullime apo shfuqizime të autorizimeve.

3. Në kryerjen e procedurave doganore eksportuesi ose importuesi duhet të paraqesë autorizimin e lëshuar nga autoriteti përgjegjës për kontrollin shtetëror të eksporteve.

4. Në rastet kur plotësohet deklarata doganore dhe konfirmohet që deklaruesi nuk është pajisur me autorizimin përkatës, autoritetet doganore duhet të bllokojnë mallrat dhe të njoftojnë importuesin/eksportuesin për mundësinë e kërkesës për autorizimin përkatës, sipas dispozitave të këtij ligji.

5. Nëse brenda 90 ditëve nga bllokimi i mallrave, subjekti deklarues nuk ka paraqitur kërkesë pranë autoritetit përgjegjës për kontrollin shtetëror të eksporteve ose kërkesa është refuzuar, autoritetet doganore duhet të refuzojnë hyrjen/daljen e këtij malli ose ta asgjësojnë atë sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi.

Neni 28

Shkeljet e legjislacionit në fushën e kontrollit shtetëror të eksporteve

Shkeljet e mëposhtme, të kryera nga personat fizikë/juridikë, kur nuk përbëjnë vepër penale sipas Kodit Penal, përbëjnë kundërvajtje administrative:

a) eksporti, importi, tranziti, ofrimi i shërbimeve për produktet që mund të përdoren për dënime me vdekje, torturë ose dënime apo trajtime mizore, çnjerëzore ose poshtëruese në mungesë të autorizimit, sipas procedurave ligjore;

b) eksporti, importi, tranziti, ofrimi i shërbimeve për produktet që mund të përdoren për dënime me vdekje, torturë ose dënime apo trajtime mizore, çnjerëzore ose poshtëruese, të lëshuara në bazë të dokumenteve false ose të dokumenteve që përmbajnë informacion të rremë;

c) eksporti, importi, tranziti, ofrimi i shërbimeve të produkteve që mund të përdoren për dënime me vdekje, torturë ose dënime apo trajtime mizore, çnjerëzore ose poshtëruese, në kundërshtim me kushtet e parashikuara në autorizim, duke përfshirë ndërhyrjen dhe bërjen e ndryshimeve në

marrëveshjen/kontratën ekonomike me vendet e huaja pa dijeninë e autoritetit përgjegjës të kontrollit shtetëror të eksporteve, si dhe tek emrat dhe kushtet e vendosura nga eksportuesi, importuesi, ndërmjetësi dhe përdoruesi i fundit dhe te përshkrimi i mallrave, deklaratimet për përdorimin e fundit dhe dhënien e garancive;

ç) ndryshimi i destinacionit të produkteve që mund të përdoren për dënime me vdekje, torturë ose dënime apo trajtime mizore, çnjerëzore ose poshtëruese, gjatë transferimeve ndërkombëtare dhe përdorimi për qëllime të ndryshme apo nga përdorues të fundit të tjerë, të ndryshëm nga ajo që është deklaruar në marrëveshjen/kontratën ekonomike me vendet e huaja dhe në dokumentet e tjera që lidhen me të, në bazë të të cilave është lëshuar autorizimi ndërkombëtar i importit;

d) fshehja e qëllimshme e informacionit, që mund të ndikojë në marrjen e vendimeve për dhënien e autorizimit;

dh) shkatërrimi i qëllimshëm i dokumenteve që lidhen me transferimin ndërkombëtar të produkteve që mund të përdoren për dënime me vdekje, torturë ose dënime apo trajtime mizore, çnjerëzore apo poshtëruese, në bazë të të cilave është lëshuar autorizimi përpara afatit të parashikuar në legjislacionin në fuqi;

e) krijimi i pengesave në ushtrimin e detyrës zyrtare nga punonjësit e autoritetit përgjegjës për kontrollin shtetëror të eksporteve dhe organet e tjera shtetërore, që kryejnë kontrollin shtetëror të eksporteve, sipas kompetencave ligjore të legjislacionit në fuqi;

ë) refuzimi i pabazuar për dhënien e informacionit dhe të dokumenteve të kërkuara nga autoriteti përgjegjës për kontrollin shtetëror të eksporteve ose nga ndonjë organ tjetër, që kryen kontrollin shtetëror të eksporteve, brenda kompetencave të tij ligjore, dhe shtrembërimi me dashje apo fshehja e tyre;

f) mosinformimi me shkrim i autoritetit përgjegjës për kontrollin shtetëror të eksporteve brenda një afati prej 15 ditësh për çdo ndryshim lidhur me autorizimin e lëshuar;

g) moskthimi i autorizimit që nuk është zbatuar pranë autoritetit përgjegjës për kontrollin shtetëror të eksporteve brenda një afati prej 15 ditësh nga data e skadimit të saj.

Neni 29

Sanksionet administrative

1. Autoriteti përgjegjës për kontrollin shtetëror të eksporteve vendos dënim me gjobë ndaj subjekteve tregtare të përfshira në eksport, import, tranzit, ofrim shërbimesh për produktet e kontrolluara si më poshtë:

a) për shkeljet e parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “c” dhe “ç” të nenit 28 të këtij ligji nga 50 000 (pesëdhjetë mijë) – 500 000 (pesëqind mijë) lekë;

b) për shkeljet e parashikuara në shkronjat “d”, “dh”, “e” dhe “ë” të nenit 28 të këtij ligji nga 20 000 (njëzet mijë) – 200 000 (dyqind mijë) lekë;

c) për shkeljet e parashikuara në shkronjat “f” dhe “g” të nenit 28 të këtij ligji nga 10 000 (dhjetë mijë) – 100 000 (njëqind mijë) lekë.

2. Subjekteve të përmendura në pikën 1, përsëritëse të shkeljeve të parashikuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 1 të këtij neni, përveç gjobës, mund t’u caktohet një masë shtesë që ndalon kryerjen e eksportit, importit, tranzitit, ofrimit të shërbimeve për produktet e kontrolluara. Masa shtesë e përcaktuar vendoset për një periudhë deri në 3 vjet nga data e vendimit përfundimtar.

3. Autoriteti përgjegjës për kontrollin shtetëror të eksporteve, përveç sanksioneve administrative, të parashikuara në pikat 1 dhe 2 të këtij neni, mund të shfuqizojë autorizimin dhënë këtyre subjekteve kur ata përsërisin shkeljet apo nuk marrin masa për t’i korrigjuar ato.

4. Në rastet e hetimit penal për vepra penale të lidhura me aktivitetin e tregtisë së mallrave, objekt i këtij ligji, apo me sigurinë kombëtare, autorizimi i lëshuar nga autoriteti përgjegjës për kontrollin shtetëror të eksporteve mund të pezullohet deri në përfundim të hetimit të çështjes penale.

5. Të ardhurat e arkëtuara nga sanksionet administrative kalojnë në buxhetin e shtetit.

6. Kundër masave të vendosura sipas këtij neni, subjekti ka të drejtë të ankohet në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative.

DISPOZITAT E FUNDIT

Neni 30

Trajtimi i të dhënave personale

Të dhënat personale përpunohen dhe shkëmbehen në përputhje me legjislacionin që rregullon të dhënat personale në Republikën e Shqipërisë.

Neni 31

E drejta i informimit

E drejta i informimit për procedurat dhe shpërndarja e informacionit të mbledhur do të bëhet në përputhje me ligjin për të drejtën e informimit në Republikën e Shqipërisë.

Neni 32

Publikimi i vendimeve

Autorizimet e lëshuara dhe vendimet për pezullimin dhe shfuqizimin e tyre, të marra në bazë të këtij ligji, publikohen në Regjistrin Kombëtar të Licencave, Autorizimeve dhe Lejeve.

Autorizimet e përcaktuara në këtë ligj bëjnë pjesë në fushën I, kategoria 1.1, “Siguria kombëtare, rendi publik dhe mbrojtja civile”, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë.

Neni 33

Aktet nënligjore

Ngarkohet Këshilli i Ministrave që brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji të miratojë aktet nënligjore në zbatim të pikës 5 të nenit 3, të pikës 5 të nenit 9, të pikës 6 të nenit 13 dhe të pikës 7 të nenit 17 të këtij ligji.

Neni 34

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 6 muaj pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 23.3.2023.

**Shpallur me dekretin nr. 54, datë 11.4.2023, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bajram Begaj.**